



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

KEC

Kodi: 063

VLERËSIMI ORGANIZATIV DHE ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Tipi i Programit: Plotësues

Historiku i Programit

Mungesa e programeve për vlerësimin organizativ të institucioneve arsimore bëri që Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) të hartojë një program të përshtatshëm të cilin mund ta përdorin organizatat e ndryshme për të bërë vlerësimin e performancës së tyre. Programi i përgatitur synon të aftësojë pjesëmarrësit në hartimin e një metodologjie efektive të vlerësimit të aspekteve të ndryshme organizative, e cila fokusohet në mënyrë të veçantë në identifikimin e nevojave për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore si elementi më i rëndësishëm në rritjen e performancës së një organizate. Programi është realizuar me mbështetjen e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.

Programi i trajnimit mbështetet në modulin “Vlerësimi organizativ dhe zhvillimi i burimeve njerëzore”, i cili është hartuar duke shfrytëzuar përvojat e shteteve të ndryshme në vlerësimin organizativ, si dhe në literaturën që shfrytëzojnë organizatat e specializuara në këtë fushë.

Qëllimet e Programit

Me përvetësimin e këtij Programi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje:

- Të njohin procesin e ndryshimit dhe zhvillimit të organizatave
- Të fitojnë shkathtësi relevante për zbatimin e formave të ndryshme të vlerësimit dhe vetëvlerësimit organizativ
- Të praktikojnë dhe të përgatisin një metodologji për të udhëhequr një proces të vlerësimit dhe vetëvlerësimit organizativ,
- Të përgatisin një plan individual për zhvillim profesional,

- Të krahasojnë praktikat aktuale të organizatës me disa shembuj vendorë e ndërkombëtarë.

Përmbajtja

Ndryshimi dhe zhvillimi i organizatës. Vlerësimi në organizatat arsimore. Palët me interes në organizatë dhe ekipet për vlerësim. Hyrje në vlerësim dhe vet-vlerësim. Planifikimi për vlerësim dhe vet-vlerësim. Çështje të performancës dhe zhvillimi i treguesve. Ndërmarrja e vlerësimit dhe vet-vlerësimit. Diagnostikimi i performancës së organizatës. Dallimi në mes të vlerësimit dhe inspektimit. Motivacioni i organizatës. Kapaciteti i organizatës. Vlerësimi i performancës së organizatës. Zhvillimi i resurseve njerëzore. Plani individual për zhvillim profesional. Menaxhimi i planeve dhe zhvillimi i kapaciteteve të personelit.

Grupi i synuar

Ky program i dedikohet përfaqësuesve të MASHT, të DKA, drejtorëve të shkollave, si dhe mësimitdhënësve të niveleve të ndryshme. Po ashtu, programi mund të jetë i dobishëm edhe për studentët e fakultete që përgatisin mësimitdhënësit e ardhshëm dhe të atyre që ofrojnë kurse lidhur me menaxhimin e organizatave të ndryshme.

Metoda e punës për realizimin e programit

Programi organizohet në formë të një seminari 4-ditorë ose në formë të 2 seminareve 2-ditore. Gjatë trajnimit prezantohen aktivitete të cilat kërkojnë angazhim të pjesëmarrësve për të kompletuar të gjitha fazat e përgatitjes së një metodologjie të vlerësimit të organizatave. Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim është 20-25.

Programi ka gjithsej **32 orë**.

Vlerësimi/Certifikimi

Kusht për certifikimin për pjesëmarrje është përcjellja me rregull e seminareve mbi 90% dhe përgatitja e një plani për zhvillim profesional.

Materialet e trajnimit

Moduli “Vlerësimi organizativ dhe zhvillimi i burimeve njerëzore”, KEC, 2014.